



KF Partizani i ka patur te gjitha mundesite qe te sigurate nje rezultat te favorshem qe ta ndihmonte per ndeshjen e kthimit ne Tirane, por eshte mundur 3-1 nga skuadra Norvegjeze e cila u ndihmua edhe nga vendimet gabuese te gjyqtareve te takimit. Vendasit shenuan qe ne fillim te takimit ndaj Partizanit qe pothuajse gjysmen e titullareve i kishte ne stol ne fillim te takimit. Pas dy golave te shenuar nga norvegjezet, Fazlliu i futur ne loje ne pjesen e dyte e ngushtoi rezultatin duke shenuar golin e vetem per te kuqte. Por nje gabim fatal i gjyqtareve te takimit te cilet akorduan nje gol te parregullut, pasi gjate aksionit sulmues te skuadres vendase, topi i goditur nga lojtari norvegjez nuk e kaloi vijen fatale. Partizani ka akoma shpresa per tu kualifikuar por do te jete shume e veshtire per skuadren e Staroves. Takimi i kthimit luhet ditën e enjte